



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2076/1 Prot

Tiranë, më 01/09/2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.695 prot, datë 26.08.2020 “Njoftim për vend të lirë pune në pozicionin sekretar shkolle” të Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike Tiranë, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2076 prot, datë 26.08.2020, **ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 02.09.2020, si më poshtë:**

Pozicioni i punës:

- Një sekretar shkolle

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kritere të posaçme

- a) të ketë nivelin arsimor në fushën e kërkuar në shpalljen për pozicionin përkatës;
- b) të ketë përvojë në punë sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit

a) letërmotivimi për pozicionin;

b) CV (jetëshkrimi), e cila plotësohet sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

c) fotokopje e kartës së identitetit, e diplomës dhe e librezës së punës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

e) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

f) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

h) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit të dorëzohen në protokollin e Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike Tiranë, brenda datës 11.09.2020

